

Bazuar në Urdhërin nr. 8180 Prot, datë 29.12.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore “Për hapjen e procedurës së rekrutimit të personelit nëpërmjet konkurimit të hapur”, Instituti i Sigurimeve Shoqërore shpall vend të lirë pune për pozicionin:

1. Specialist i kontabilitetit, implementimi programi i ri, në Sektorin e Kontabilitetit, pranë Drejtorisë së Financës.

1 vend pune

Kandidati konkurus:

- Duhet të zotërojë Diplomë në nivel “Master Profesional” ose të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të Arsimit të lartë në Shkencat ekonomike/Dega Financë/Kontabilitet;
- Duhet të ketë të paktën dy vjet punë në nivel specialisti në administratë publike/shërbim civil, ose dhe minimumi dy vjet punë në sektorin privat, në profesion.

Kandidati që konkuron duhet të plotësojë kërkesat si më poshtë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore, shërbimi civil ose administrata publike, që nuk është shënuar, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**Fushat e njoburive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim & intervista**

Kandidati do të testohet në lidhje me:

- Njohuritë në fushën e Sigurimeve Shoqërore (statusi i ISSH-së, Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Njohuri të Rregulloreve të përfitimeve, kontributeve, financiare, personelit dhe për sistemin e informacionit të ISSH;

- Njohuri të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat"; Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike".

### **Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

Në vlerësimin e kandidatëve, përfshihen:

- a) vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve: që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën;
- b) vlerësimi me shkrim: që konsiston në vlerësimin e njohurive për legjislacionin e zbatueshëm për sigurimet shoqërore, organizimin administrativ në sistemin e sigurimeve shoqërore, për nivelin e njohurive akademike dhe profesionale, bazuar në kriteret e përcaktuara;
- c) intervista me gojë, ku zhvillohet intervistimi i kandidatëve, i cili synon të evidentojë formimin e përgjithshëm, si dhe vizionin e tyre mbi veprimtarinë e sigurimeve shoqërore dhe për pozicionin që konkuron.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, deri në 20 pikë;
- b) për intervistën me gojë, deri në 40 pikë;
- c) për vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë.

Kandidati konkurus kualifikohet nëse në total ka fituar mbi 70 pikë nga 100 pikë të mundshme, gjatë fazës së vlerësimit.

### **Dorëzimi i dokumentave:**

Kandidati duhet të dorëzojë në zyrën e protokollit:

- Një kërkesë për konkurim për pozicionin e punës për të cilin është i interesuar;
- Një kopje të jetëshkrimit (CV);
- Fotokopje e diplomës dhe listës së notave (e noterizuar);

- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Raport të aftësisë për punë;
- Fotokopje të librezës së punës;
- Certifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
- Fotokopje të kartës së identitetit.

Personat e interesuar për të qenë pjesëmarrës në konkurim duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 18.01.2021, pranë zyrës së prokoll/sekretarisë, në Drejtorinë e Administrimit të Përgjithshëm, ISSH.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më lart.

**Testimi me shkrim** do të zhvillohet në ambjentet e ISSH në datën **27.01.2021, ora 10**.

**Intervista me gojë** do të zhvillohet në ambjentet e ISSH në datën **01.02.2021, ora 10**.